

**VENDIM**  
**Nr. 12/2024**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 70/2021, “PËR CAKTIMIN  
E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE  
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Në pikën V të vendimit nr. 70/2021, “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

“Deputeti Plarent Ndreca caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 25.1.2024.